

# FREKUENTONI SOT, DILJANI MBANË NESËR.

Studimet tregojnë se nxënësit me frekuentim të mirë kanë më shumë gjasa që: të kenë rezultate të mira në lexim dhe matematikë në nivelin e klasës ose mbi të; të krijojnë marrëdhënie të qëndrueshme që mbështesin mirëqenien e tyre sociale dhe emocionale; dhe ta mbarojnë shkollën e mesme në kohë.

The School District of Philadelphia ju gjendet pranë. Përdorni këtë listë kontrolli për t'u siguruar që nxënësi juaj është gati të ndjekë shkollën në ditën e parë, më 5 shtator dhe çdo ditë gjatë vitit shkollor.

## PARA fillimit të vitit shkollor



- **Sigurohuni që fëmija juaj të jetë i përditësuar për vaksinimet e nevojshme**  
Vaksinat falas të kërkuara nga shkolla janë të disponueshme në çdo [CityLife Health Clinic](#) ose [City Health Center](#) të Filadelfisë. Caktoni një takim në [philasd.org/vax](#) ose telefononi në nr. 1-877-926-9272.
- **Mësoni orarin e ziles dhe të autobusit të fëmijës tuaj**  
Kontrolloni faqen e internetit të shkollës ose telefononi zyrën e shkollës për detaje.
- **Planifikoni rutinën tuaj ditore me fëmijën tuaj**  
Vendoseni diku në shtëpi duke përdorur rikujtuesin tonë *Daily Routine (rutina ditore)*. Me afrimin e shkollës, filloni të përshtatni orarin e gjumit të fëmijës tuaj dhe ta zgjoni më herët nëse është e nevojshme për ta bërë më të lehtë mbërritjen në kohë në shkollë.
- **Bëni një plan, si dhe planin rezervë, për të shkuar në kohë në shkollë**  
Është shumë e rëndësishme të keni njerëz në jetën tuaj që ju përkrahin. Kërkojini familjes, shoqërisë ose fqinjëve tuaj që t'i keni si rezervë në për dërgimin e fëmijës në shkollë. Si dhe bëni dhe ju të njëjtën gjë për ta.

- **Planifikoni që përpara për ditët me orar të shkurtuar në punë**  
Mësimi vazhdon në këto ditë, kështu që sigurohuni që fëmija juaj ta frekuentojë shkollën dhe të ketë një plan kujdesi pas shkollës nëse është e nevojshme.
- **Jeni shpërngulur? Keni marrë nr. të ri telefoni? Përditësoni informacionin tuaj të kontaktit**  
Pasja e informacionit të saktë në dosje i lejon personelit të shkollës të ruajë kontaktin me ju për frekuentimin dhe çështje të tjera, si dhe në raste emergjencash.
- **Regjistrohuni për një llogari në portalin Parent and Family (prindi dhe familja) nëse nuk e keni ende**  
Aty ju vihen në dispozicion në çdo kohë informacione si frekuentimi i fëmijës suaj, notat dhe rezultatet e provimeve. Regjistrohuni te [philasd.org/pfportal](#).

## GJATË vitit shkollor

- **Festojeni frekuentimin e rregullt në shtëpi**  
Bëjani të ditur fëmijës se jeni të interesuar për shkollën, sepse kur ju përkushtoheni, edhe fëmija përkushtohet! Përforconi faktin se pjesëmarrja është çelësi i suksesit të tyre akademik dhe në jetë. Përdorni *Weekly Attendance Tracker* (raportin e frekuentimit javor) dhe *Attendance Hero Certificate* (certifikatën e frekuentimit të suksesshëm) për ta bërë diçka argëtuese për të gjithë.
- **Flisni me drejtorin e fëmijës tuaj, mësuesit ose infermieren e shkollës.**  
Nëse keni ose prisni të keni sfida me frekuentimin, ata mund t'ju ndihmojnë.



Vizitoni [philasd.org/attendtoday](#) për të marrë rikujtuesin Morning Routine (rutina e mëngjesit), Attendance Tracker (raportin e frekuentimit) dhe Hero Certificate (certifikatën e suksesit), si dhe materiale dhe informacione të tjera për frekuentimin.